



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË
INFRASTRUKTURËS**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. _____

I nderuar

Në përgjigje të shkresës tuaj “Kërkesë për informacion” protokolluar në bashki me datë 24.07.2023, ju informojmë:

Në kuadër të masave që po merren në vazhdimësi për përmirësimin e qarkullimit rrugor kryesisht gjatë stinës së verës për të krijuar lehtësi në lëvizje për qytetarët e Shkodrës dhe vizitorët e shumtë vendas e të huaj që kanë destinacion Bashkinë Shkodër gjatë sezonit turistik, është bërë vëzhgimi i situatës në rrugët të cilat kanë ngarkesë të madhe në qarkullim dhe bllokim trafiku nga ku vlerësojmë të nevojshme të merren masa për përmirësime të skemës së qarkullimit në disa rrugë.

Pas konsultimeve edhe me specialistë të qarkullimit rrugor dhe të policisë bashkiake është vlerësuar të nevojshme që gjatë sezonit turistik të merren masa të përkohshme për përmirësimin e skemës së qarkullimit në disa rrugë ku përfshihen rrugët për të cilat kërkoni informacion si më poshtë:

1. Në Bulevardin “Zogu i Parë” ka qenë me kalim në dy drejtime lëvizjeje, në njërin drejtim parkim i lejuar dhe në krahun tjetër korsi biçikletash. Gjithashtu edhe kalimi dhe qëndrimi i mjeteve të transportit urban dhe të mjeteve të shërbimeve publike në të dy krahët krijojnë vështirësi dhe shpeshherë bllokim të qarkullimit në këtë aks.

Është vendosur që Bulevardi “Zogu i Parë” të jetë me një drejtim qarkullimi nga sheshi Zogu i Parë në drejtim të sheshit Balshaj.

2. Rruga “Daut Boriçi” ka qenë me kalim në dy drejtime lëvizjeje, në njërin drejtim parkim i lejuar dhe në krahun tjetër korsi biçikletash e ndërtuar kohët e fundit në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës për përdoruesit e biçikletave. Kjo ngarkesë ka krijuar vështirësi dhe shpeshherë bllokim të qarkullimit.

Është vendosur që Rruga “Daut Boriçi” të jetë me një drejtim qarkullimi nga Sheshi “Isa Boletini” në drejtim të sheshit “Zogu i Parë”.

Vendimarrja është bërë në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23/6; Ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 ” Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë “, neni 6/1; VKB nr. 9 datë 27.02.2014 “Për rregullimin e qarkullimit rrugor dhe përcaktimin e disa vendqëndrimeve të mjeteve të transportit në qytetin e Shkodrës” Paragrafi VIII, ku shprehet: “Autorizohet Kryetari i Bashkisë Shkodër për të bërë rregullime të nevojshme në raste të veçanta”.

Nga kjo vendimarrje ka patur ndikim pozitiv tek qytetërit pasi ka një lehtësi më të madhe qarkullimi dhe rrjedhshmëri, ka rritur sigurinë për kalimtarët, përdoruesit e biçikletave dhe automjeteve. Si rezultat i këtyre masave do të ketë ulje të ndotjes së ajrit për shkak të shkurtimit të kohës së qëndrimit të mjeteve në rrugë.

Ndikim pozitiv ka patur edhe tek përdoruesit e transportit urban pasi është reduktuar koha për realizimin e intenerarit të lëvizjes së autobuzëve urban dhe kjo bën të mundur shkurtimin e kohës së pritjes për qytetarët.

Masat e mësipërme janë të përkohshme për përmirësimin e qarkullimit rrugor kryesisht gjatë sezonit turistik pasi Bashkia Shkodër së shpejti do të hartojë një plan mobiliteti me ekspertë të fushës, në konsultim me institucionet dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR

Benet BECI

